



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE
TË DELEGUARA

Nr. 197/1 prot.

Elbasan, më 10. 2. 2025

Lënda: Kthim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr. 6 datë 31.01.2025 “Mbi ndarjen e bursave për nxënësit e viteve të para të arsimit profesional për vitin shkollor 2024- 2025”, vlerësojmë se akti juaj nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas argumentave më poshtë:

Në pikën nr.32 dhe 33 të VKM – së nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” (e ndryshuar), parashikohet:

32. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë e shkollave, është muaji dhjetor.

33. Vendimet e këshillave të njërive të vetëqeverisjes vendore, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afati vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse

Vendimi juaj është miratuar me datë 31.01.2025 , përtej afatit të parashikuar në VKM – në e referuar më lart.

Për sa më sipër akti juaj nuk konfirmohet pasi është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

PREFEKTI
AI MYSLIU

197
04.2.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.04.02.2025

Nr. 673 prot

Nr.6 dt.31.01.2025

**“MBI NDARJEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E VITEVE TË PARA TË
ARSIMIT PROFESIONAL PER VITIN SHKOLLOR 2024-2025”**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” nenin 30 ‘Funksionet dhe kompetencat e deleguara’, nenin 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, në V.K.M. nr. 666dt.10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe percaktimin e kriterëve për perfitimin e bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2024-2025” si dhe në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.5169 Prot. dt. 24/10/2024 “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënës të ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mesimor 2024-2025”. Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më datë 31.01.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

Të miratojë bursë të plotë për nxënës sipas listës së mëposhtme:

1. Ledjan Resmi Hida: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Dega SHMT” Elbasan
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori I Arsimit Kulturës Sportit dhe Organizimit të Aktiviteteve dhe Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd.
3. Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU

